



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1145/5 prot.

Datë 06.07.2022

V E N D I M
Nr. 637/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.07.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-30235-05-20-2022, me objekt “Dezinsektim i parqeve dhe objekteve në parqe”, me fond limit 3,332,800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues: “Operatori ekonomik “Egian Med” SHPK
Adresa: Rruga “Kavajës”, Condor Center, kati 4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
Adresa: Rruga “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.05.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-30235-05-20-2022, me objekt “*Dezinsektim i parqeve dhe objekteve në parqe*”, me fond limit 3,332,800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 30.05.2022, operatori ekonomik “*Egian Med*” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, me nr. 1145/2022 protokoll, për procedurën e mësipërme të prokurimit duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi

II.3. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1287/3 prot., datë 02.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1145/2 prot., datë 07.06.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Egian Med*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Egian Med*” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar pretendimin lidhur me pikën 2.1 të ankesës (pikën 2.2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me vlerën e xhiros), si dhe është pranuar pjesërisht pretendimi lidhur me pikën 2.2 të ankesës (pikën 2.3.1 dhe 2.3.2 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me furnizimet e mëparshme të ngjashme në sektorin publik, në lidhje me vërtetimin e realizimit ose faturë tatimore shitje, si dhe rishikimin e dokumentacionit provues për furnizimet e mëparshme të ngjashme të përcaktuar në pikën 2.3.2 të DST).

II.6. Në datën 09.06.2022 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 543/2022 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-30235-05-20-2022, me objekt “*Dezinsektim i parqeve dhe objekteve në parqe*”, me fond limit 3,332,800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 25 prot., datë 14.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1145/4 prot., datë 16.06.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacion plotësues nga ana e operatorit ekonomik ankimues “*Egian Med*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Në lidhje me specifikimet teknike të vendosura në dokumentet e tenderit ne shtojcën 5, ndër të tjera AK ka kërkuar Preparatet e dezinfektimit që do të përdoren janë produkte larvicide biologjike për mushkonja Bti + Bs: *Bacillus thuringensis israeliensis*, shtami AM65-52 i kombinuar me *bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743, që përdoret në të gjitha pusetat ku depozitohen larvat e mushkonjave...”. Produkt i gatshëm me veprim fiziko mekanik për kontrollin e larvave të mushkonjave MMF (mono molecular film) (produkti nuk përmban substancë të klasifikuara të rrezikshme për.....) Këtë produkt me këto specifikime, pra kombinimin e *Bacillus thuringensis israeliensis*, shtami AM 65-52 me *bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743 dhe Produkt i gatshëm me veprim fiziko mekanik për kontrollin e larvave të mushkonjave MMF (mono molecular film) (produkti nuk përmban substancë të klasifikuara të rrezikshme për..., e cila quhet VECTOMAX FG e prodhon vetëm një kompani në botë e konkretisht kompania amerikane “Valent BioSciences”, me distributor në Europë Kompaninë Sumitomo në Francë dhe distributor ekskluziv në Shqipëri, kompania “NRG” ShPK. Fakti se ky produkt është monopol është lehtësisht e verifikueshme sepse mjafton të kërkosh në internet këtë kombinim produktesh dhe të del produkti i emërtuar “Vectomax Fg”, produkt të cilin e prodhon vetëm kompania “Valent BioSciences”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar, si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Preparatet e dezinfektimit që do të përdoren janë produkte larvicide biologjike për mushkonja

a. Bti *Bacillus thuringiensis subsp. israeliensis*, shtami AM65-52 i cili përdoret në sipërfaqet me ujë të ndenjtur dhe ku depozitohen larvat e mushkonjave

b. Bti + Bs: *Bacillus thuringensis israeliensis*, shtami AM65-52 i kombinuar me *bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743, që përdoret në të gjitha pusetat ku depozitohen larvat e mushkonjave.

c. OE duhet të disponojë skedat teknike të produkteve të përdorura dhe certifikatat e regjistrimit në BE, USA, Kanada ose Zelandën e Re.

ç. Autorizimin Prodhuesit për Shqipërinë apo kontratë me Distributorin e Autorizuar për Shqipërinë.

d.i. Preparati do të përdoret max 1kg/ha (ne baze te etiketes se produktit), për sipërfaqen e kërkuar.

2. Produkt i gatshëm me veprim fiziko-mekanik per kontrollin e larvave te mushkonjave MMF (mono molecular film)(produkti nuk permban substance te klasifikuara te rrezikshme per shendetin ose mjedisin ne saj qe kerkojne nje deklarate ne perputhje me dispozitat e Rregullores (EU), eshte produkt natyral dhe nuk konsiderohet aspak i rrezikshem.

g. Autorizimin e prodhuesit për Shqipërinë apo kontratë me Distributorin e Autorizuar për Shqipërinë.

3. Preparatet e dezinfektimit qe do te perdoren per insektet zvarritese dhe fluturuese si psh. (buburrecat, milingonat, mizat, pleshtat, rriqnat dhe shume insekte te tjere qe bartin semundje te jete me permbatje alfa-cipermetrine 5.8%, si dhe cipermetrine 10% dhe tetrametrine 2%, PBO 15%.

4.Preparati qe do te perdoret per luftimin dhe mbajtjen larg te brejtesve duhet te jete me permbajtje alfa-kloraloze, bromadilione.

5. Preparati qe do te perdoret per largimin e zvarranikeve te jete natyral me perberje vaj kamfure.

6. Preparat Biologjik, me permbatje natyrale per eliminimin e (gazrave, aromave te keqija, pushtave, ujrave te ndotura) qe lindin si efekt i jashqitjeve te kafsheve, presioneve te ulta atmosferike, etj.

7. Preparat biologjik me permbajtje natyrale, qe ben te mundur degradimin, stabilizimin, dezinfektimin, te elementeve organik te ngurte dhe te lengshem.

8. Per te gjitha keto produkte duhet te paraqiten dokumentacionet perkatese me skedat e te dhenave te sigurise si dhe etiketat perkatese te produkteve.

9. Metoda e trajtimit qe do të përdoret për sipërfaqet me ujë të ndenjmur është me metoda Cold Fogging si dhe ajo me pompe me presion te larte.

10. Shërbimi i dezinfektimit do të kryhet për trajtimet kundër larvave te mushkonjave dhe do të kryhet vetëm gjatë natës

11. Në fund të shërbimit operatori që do të përzgjidhet për kryerjen e shërbimit duhet të lëshoj certifikatën në prezencë të punonjësit të APR- së, për kryerjen e shërbimit ku të tregohen preparatet e përdorura në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet njëvlershmëria/barazvlefshmëria ose ekuivalent.

12. Dokumentacioni i paraqitur duhet te jete ne gjuhen shqipe i perkthyer dhe noterizuar.

Specifikimet teknike për teknikat e trajtimeve

1. **Teknika “Cold fogging”** bën të mundur aplikimin e Bti në formën e mjegullës së ftohtë. Rekomandohet kryesisht për kontrollin e mushkonjës tigrë *Aedes albopictus*. Aplikimi i kësaj teknike kërkon kushte specifike dhe eksperiencë për t’u aplikuar në mënyrë efikase. Kalibrimi i pajisjes mjegulluese për përdorim me lëndën aktive Bti dhe zbatimi i të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara është mjaft i rëndësishëm për të pasur efektivitet në trajtim. Trajtimi me këtë teknikë kryhet gjatë natës pasi teknika është me efektive kur temperatura e ajrit ulet krahasuar me temperaturën gjatë ditës duke ndihmuar dekantimin e grimcave të Bti me madhësi 80-100 mikron si dhe për të mos shqetësuar pushuesit dhe qytetarët. Aplikimi rekomandohet mesatarisht çdo dy javë.

Teknika “Cold fogging” mjegull e ftohtë, ka të bëjë me aplikimin e produktit me anë të një aparati mjegullues (nebulizator) që prodhon mjegull të ftohtë, i montuar në një kamionçinë.

- Sasia e produktit që duhet të aplikohet nga sistemi i mjegullimit duhet të jetë 100 litra/orë.
- Madhësia e piklave duhet të jetë 80 – 100 mikron.
- Rezervuari duhet të jetë me tank të madh me volum jo më pak se 300 litra për të realizuar trajtimin sipas zonave përkatëse për një kohë të shkurtër.
- Rezervuari duhet të jetë i pajisur me përzierës (agitator).

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të disponojë pajisjen mjegulluese (nebulizator) të montuar në një kamionçinë, sipas karakteristikave të mësipërme;
- Kalibrimi i pajisjes duhet të bëhet çdo herë në fillim të sezonit të trajtimit, në prani të AK;
- Kamionçina duhet të lëvizë me shpejt 8 – 10 km/h;
- Trajtimi duhet të bëhet gjatë natës dhe të përfundojë përpara lindjes së diellit;
- OE nuk duhet të bëjë trajtim nëse shpejtësia e erës i kalon 10 km/h;
- Kamionçina duhet të jetë e pajisur me aparat GPS për të regjistruar trajtimin;

2. **Teknika Pompë me presion të lartë me Bti** mundëson aplikimin e Bti me anë të një aparati (pompë) të montuar në një kamionçinë. Rekomandohet për trajtimin e kanaleve dhe habitateve me vegjetacion shumë të dendur ku është gjetur kryesisht mushkonja e zakonshme *Culex pipiens*.

Teknika me mjetin Pompë me presion të lartë

- Presioni i pompës duhet të jetë > 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min;

- Rezervuari duhet të jetë me tank të madh me volum jo më pak se 300 litra për të realizuar trajtimin sipas zonave përkatëse për një kohë të shkurtër;
- Rezervuari duhet të jetë i pajisur me një sistem përzierës (agitator).

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- OE duhet të disponojë aparatën (pompën me presion të lartë), sipas karakteristikave të mësipërme, të montuar në një kamionçinë, e cila mund të jetë e montuar bashkë edhe me aparatën mjegulles në po të njëjtën kamionçinë.
- Shpejtësia e lëvizjes së kamionçinës nuk duhet t'i kalojë 8-10 km/h.
- Kalibrimi i pajisjes duhet të bëhet çdo herë në fillim të sezonit të trajtimit, në prani të AK;

3. **Atomizator shpine me motorr për lëng me Bti ËG** mundëson aplikimin e Bti ËG në formulimin e mjegullës së ftohtë me anë të një aparati atomizator të pajisur me motor dhe që mbahet në shpinë nga aplikuesi. Rekomandohet të përdoret në habitate që shërbejnë për zhvillimin e mushkonjës tigër por ku është e vështirë të futet makina me pajisjen “cold fogging” dhe në zgavrat dhe të çarat e drurëve ose pemëve. Synohet arritja dhe trajtimi specifik i vendeve të zhvillimit të mushkonjës tigër. Kalibrimi i atomizatorit është mjaft i rëndësishëm për të pasur efektivitet në trajtim.

Teknika me mjetin Atomizator shpine me motorr për lëng

- Tanku i atomizatorit duhet të jetë jo më pak se 13 litra;
- Volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 m³/orë;
- Shpejtësia minimale e ajrit në dalje të jetë > 80 m/s.

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- OE duhet të disponojë Atomizator shpine me motorr për lëng, sipas karakteristikave të mësipërme;
- Kalibrimi i pajisjes duhet të bëhet çdo herë në fillim të sezonit të trajtimit, në prani të AK;

4. **Teknika me mjetin Dozator për lëng.**

Dozator për lëng rekomandohet të përdoret për trajtimet e bodrumeve të përmblytur gropave septike dhe pusetave me ujë të ndenjur. Trajtimi kryhet duke hedhur solucionin lëngshëm të filmit një shtresor në njësi matëse në mililitra ose dozues (dozator) në varësi të sipërfaqes që duhet trajtuar. Aplikohet një herë në muaj (4 javë).

Duke qenë se ka edhe puseta të mbyllura me kapak hekuri ose të izoluara apo të pajisura me një vrimë shumë të vogël që e bën të pamundur monitorimin për praninë e larvave, sugjerojmë që të trajtohen vetëm pusetat e hapura, që kanë ujë të ndenjur, të

qendrueshëm, dhe që lejojnë monitorimin entomologjik, si dhe pusetat ku duket qartë prania e larvave në ujë pavarësisht se pajisja monitoruese për marrjen e kampioneve të larvave nuk mund të hyj në hapësirën e zgarës së pusetës.

Trajtimi i pusetave, bodrumeve të kryhet me film një shtresor (monomolekular film) në dozën 1 ml/m² (pusetë). Të mos trajtohen puseta pa ujë, apo me ujë të rrjedhshëm.

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- OE duhet të disponojë Dozator për lëng që duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për aplikimin e produktit 1ml/m².

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- OE duhet të disponojë Dozator për lëng që duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për aplikimin e produktit 1ml/m².

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar, si më poshtë:

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr	Emërtimi i mallit	Lloji produktit	Sipërfaqja për dezinsekti m m ² ose njesi	Produkt i perdorur per njesi	Nr trajtime ve
1	Sherbim per dezinsektim objekte	Bti	31840	1 kg / ha	8
2	Sherbim per dezinsektim sheshe rekreative	Bti	3550	1 kg / ha	8
3	Sherbim per dizinfektim puseta	Bti + Bs	16	10 gr /puset	16
4	Sherbim per deratizim	Kurthe minjsh plus pasta ne	35390		16

		forme karremi			
5	Sherbim per largimin e gjarperinjve	Produkt natural	35390		16

III.1.3. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.11 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.11. Etiketat e produkteve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit duhet të jenë të miratuara nga ISSH dhe duhet të jenë në gjuhën shqipe (të paraqitet një kopje e etiketave). Në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet një vlefshmëria/barazvlefshmëria ose ekuivalent.

III.1.4. Referuar procesverbalit “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstatohet se është përcaktuar, si më poshtë:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III.1.5. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë

tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e

cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.6. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.7. Në neni 15, pika 3/c “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht se:

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- *specifikimet teknike;*
- *grafikun e lëvrim;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- *termat e referencës;*
- *grafikun e ekzekutimit;*
- *kërkesat për personelin kryesor;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*

III.1.8. Në neni 41, pika 3/c “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.1.9. Në Shtojcën V “Lista e lëndëve vepruese të miratuara” të VKM nr. 933, datë 24.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” përcaktohet shprehimisht se:

SHTOJCA V
LISTA E LËNDËVE VEPRUESE TË MIRATUARA

Lista 1

Lëndët vepruese që përmbahen në produktin biocid, referuar bazës së të dhënave të ECHA-s

<i>Lënda aktive</i>	<i>Numri EC</i>	<i>Numri CAS</i>	<i>PT</i>
<i>Bacillus sphaericus 2362, shtami ABTS-1743</i>	<i>I</i> <i>pacaktuar</i>	<i>143447-72-7</i>	<i>18</i>
<i>Bacillus thuringiensis subsp. israelensis Serotipi H14, Shtami AM65-52</i>	<i>I</i> <i>pacaktuar</i>	<i>I pacaktuar</i>	<i>18</i>

III.1.10. Në Shtojcën I të VKM Nr. 487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide” përcaktohet shprehimisht se:

<i>Numri</i>	<i>Tipi i produktit</i>	<i>Përshkrimi</i>
<i>Grupi kryesor 3. Kontrolli i dëmtuesve</i>		
<i>PT 14</i>	<i>Rodenticidët</i>	<i>Përdoren në kontrollin e minjve të shtëpisë, minjve të kanaleve dhe brejtësve të tjerë më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.</i>
<i>PT 15</i>	<i>Avicidet</i>	<i>Përdoren për kontrollin e shpendëve, zogjve më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.</i>
<i>PT 16</i>	<i>Moluskicidet, vermicitet dhe produktet për kontrollin e vertebrorëve të tjerë</i>	<i>Përdoren për kontrollin e kërmijve dhe molusqeve të tjera, krimbave të ndryshëm dhe invertebrorë të tjerë, që nuk kontrollohen nga tipa të tjerë produktesh më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.</i>
<i>PT 17</i>	<i>Pishicidet</i>	<i>Përdoren për kontrollin e peshqve më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.</i>
<i>PT 18</i>	<i>Insekticidet, akaricidet dhe produktet per</i>	<i>Përdoren për kontrollin e artropodëve (p.sh, insekteve, araknidëve ose merimangave dhe akrepave dhe krustacetë ose</i>

	<i>kontrollin e artropodëve të tjerë</i>	<i>gaforret), më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.</i>
<i>PT 19</i>	<i>Repellentët dhe atraktantët</i>	<i>Përdoren për kontrollin e organizmave të dëmshëm (jovetëbrorë, si: pleshtat, kurrizorët, siç janë: zogjtë, peshqit, brejtësit), duke i zmbrapsur ose duke i tërhequr, duke përfshirë edhe ata që përdoren për higjienën e njeriut dhe kafshëve direkt në lëkurë apo indirekt në mjedisin e njerëzve apo kafshëve.</i>
<i>PT 20</i>	<i>Kontrolli i vertebrorëve të tjerë</i>	<i>Përdoren për kontrollin e vertebrorëve përveç atyre që kontrollohet me tipa të tjerë produktesh të këtij grupimi kryesor, më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.</i>

III.1.11. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK i cili shprehet se: “... Autoriteti kontraktor ta heqë këtë produkt për shkak se është produkt monopol dhe këtë produkt ta zëvendësojë me produkte të tjera të cilat nuk janë monopole të vetëm një kompanie në treg dhe që realizojnë qëllimin për të cilin është vendosur produkti i kundërshtuar nga ana jonë. Ky produkt mund të zëvendësohet shumë mirë dhe me efektivisht me produktet më bazë vetëm Bti me 3000 ITU në formë të shpërbërshme në ujë ose të tretshme në ujë për aplikimin me pajisje Cold Fogging atomizuese me makinë pick-up dhe me pompë me presion të lartë, pompë shpine me presion dhe me atomizator me lëng si edhe të zëvendësohet ose me produktin Bti granulare 200G për trajtimin me automatizor me granula dhe granulator dore”, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes me shkresën 1287/3 prot, datë 02.06.2022 drejtuar ankimuesit ka argumentuar se: “Zgjedhja e produktit Bti+Bsph AM 65-52 është bërë për shkak se është larvacide biologjike e gjeneratës së fundit të krijuar përmes teknologjisë BioFuse që lejon shkrirjen dhe kombinimin e dy lëndëve aktive. I pa dëmshëm për njerëzit dhe organizmat ujorë mund të aplikohet në kulturat organike dhe në habitatet e ndjeshme. Formulimi me bazë granulat e misrit për përdorim ushqimor, shpërndahet si në sipërfaqe dhe në fund të ujit duke krijuar shpërndarje përfekte të mikrogripcave të cilat përmbajnë Bti dhe Bsph në pjesën e ujit në të cilën ushqehen larvat e mushkonjave. AK ka si prioritet të saj sigurinë shëndetin e komunitetit duke qene se Parku i Madh i Liqenit Artificial, Sheshet rekreative janë të mbipopulluara nga grup mosha të ndryshme nga duke filluar nga 0 vjeç e deri në moshat më të moshuara, të cilat jo vetëm qarkullojnë në park por edhe qëndrojnë në vende si stola nëpër parqe, amfiteatër, kënd lojërash, fusha sportive, tualete etj. Vitet e fundit kjo procedure nuk është fituar nga shoqëria NRG ShPK për të cilën pretendon se e ka monopol këtë produkt në RSH, pra pretendimi juaj nuk qëndron dhe nuk është i bazuar në fakte dhe prova”.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve

teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara, ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, pika 1, paragrafi 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit, qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore me kusht, që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për

prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim”* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjitha kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.1.13. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2, gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh me qëllim përfitimin e një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment në specifikimet teknike dhe termat e referencës, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendë asnjë markë prodhimi

ose burim specifik apo proces të veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit dhe Shtojcës 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi nga ana e autoritetit kontraktor është plotësuar shtojca me përshkrimet konkrete të preparateve, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme, që të përcaktojë, se produktet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi duhet t’i përkasin grupit të produkteve biocide që luftojnë larvat e mushkonjave (insektet), çka është dhe qëllimi për të cilin kryhet kjo procedurë prokurimi, sipas parashikimeve të VKM Nr. 487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”, por duke mos përcaktuar emrin e produktit konkret, pasi në VKM nr. 933, datë 24.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” janë disa produkte me emërtime të ndryshme, që i përkasin kategorisë së produkteve biocide që luftojnë larvat e mushkonjave (insekteve) dhe që prodhohen nga prodhues të ndryshëm. Gjithashtu KPP konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht specifikimet teknike të lëndëve aktive *Bti Bacillus thuringensis israeliensis*, shtami AM65-52 dhe *Bs: Bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743 të preparatit të dezinfektimit për produkte larvicide biologjike për mushkonja të cilat në rast se kombinohen me njëra tjetrën janë të vetmet lëndë aktive të kombinuara që luftojnë larvat e mushkonjave apo insektet dhe se asnjë nga produktet e tjera biocide të parashikuara në VKM nr. 933, datë 21.11.2020, nuk e realizon këtë funksion. Për sa më sipër Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa në lidhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike referuar dhe kushteve atmosferike dhe habitatit ku do të kryhet shërbimi për preparatet e dezinfektimit që do të përdoren janë produkte larvicide biologjike për mushkonja *Bti + Bs: Bacillus thuringensis israeliensis*, shtami AM65-52 i kombinuar me *bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743, që përdoret në të gjitha pusetat ku depozitohen larvat e mushkonjave...”. Produkti i gatshëm me veprim fiziko mekanik për kontrollin e larvave të mushkonjave MMF (mono molecular film) (produkti nuk përmban substancë të klasifikuara të rrezikshme për.....) ose duke hequr markat/specifikimet e preparateve të cilat i adresojnë operatorët ekonomik drejtë një prodhuesi të vetëm ose ti zëvendësojnë ato me ekuivalencën e tyre, në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen dhe të rris konkurrencën si dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Egian Med ” ShPK, se: “[...]Kërkesat për të pasur në stafin e OE-së 3 (dy) teknikëve të aplikimit, certifikuar “Teknik dezinfektimi” dhe të 1 (një) punëtori teknik, certifikuar “Mbrotjtjen & menaxhimin e dëmeve të mjedisit”, nuk lidhen me objektin e prokurimit, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi dhe janë në kundërshtim me nenin 77 të LPP-së. Sikurse jeni në dijeni, në VKM 514 datë 20.09.20117 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve LKP, te rishikuar” janë përcaktuar kodet e punësimit për të gjitha profesionet. Referuar kësaj VKM- je, në faqen 800 të saj, është përcaktuar me kod profesioni “7544” kategoria e “Kontrollorëve të dezinfektimit të mjedisit për baktere, insekte dhe barëra të këqij”. Gjithashtu në këtë VKM në vijim janë përshkruar edhe Funksionet kryesore që kryejnë këta punonjës. Në kategoritë e këtij grupi njësi nuk figurojnë profesionet e cituara nga AK-ja si “teknikë aplikimi” i cili kërkohet i certifikuar “teknik dezinfektimi” dhe i punëtorit teknik, certifikuar “Mbrotjtjen & menaxhimin e dëmeve të mjedisit”, pasi të gjitha detyrat për realizimin e shërbimit të dezinfektimit i realizojnë punonjësit e emërtuar “Dezinfektues të mjedisit, për baktere, insekte, barëra të këqija, të cilët gjithashtu njohin punimin e makinerive dhe mjeteve duke përfshirë konstruksionin e tyre, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Ligji posaçëm kërkon që kompania të jetë e licencuar, licenca të cilat janë kërkuar me të drejtë nga autoriteti juaj kontraktor. Për gjithë sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Shtojcës 8 të DT, duke hequr kërkesën për 3 apo 2 (dy) “Teknik dezinfektimi” (ndryshe e shkruar AK-ja me fjalë dhe ndryshe me shifra) dhe “punëtor Teknik”, certifikuar “Mbrotjtjen & menaxhimin e dëmeve të mjedisit” pasi nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe ky numër të kërkohet punonjës dezinfektimi, pra në total të kërkohen 10 (dhjetë) punonjës nga të cilët 1(një) drejtuesi teknik dhe 9 (nëntë) punonjës “Dezinfektues të mjedisit, për baktere, insekte, barëra të këqij”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimit ne objekt kontrate, duhet të disponojë e 10 punonjes kjo e vertetuar me kontrata pune te vlefshme, certifikime perkatese, stafi duhet te jete i regjistruar me kodet perkatese si dezinfektues sipas legjislacionit ne fuqi, konkretisht:

- 1 (nje) drejtues teknik;
- 3 (dy) teknik aplikimi, certifikuar “Teknik dezinfektimi”
- 5 (tre) punonjes dezinfektimi, dezinfektimi, certifikuar “dezinfektues”
- 1 (nje) puntor teknik, certifikuar “Mbrotjtjen & menaxhimin e dëmeve të mjedisit”

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin pjestar të stafit teknik mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë / certifikatën e kualifikimit.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.5. Në nenin 41, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.6. Në lidhje kundërshtimin e kërkesën për disponueshmërinë e 3 (dy) teknikëve të aplikimit, certifikuar “Teknik dezinfektimi” dhe të 1 (një) punëtori teknik, certifikuar “Mbrojtjen & menaxhimin e dëmeve të mjedisit”, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të LPP-së. Në rastin konkret, referuar specifikimeve teknike teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit, Komisioni gjykon, se kërkesa në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar sipas profileve të ndryshme është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Referuar specifikimeve teknike, këto procese shërbimi që do të kryhen, duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe frekuentimin e mjediseve nga grupmosha të ndryshme, por duke marrë në konsideratë edhe florën dhe faunën që ndodhet në mjedisin në të cilin do të ndërhyhet, janë procese delikate që kanë nevojë për persona të trajnuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e ka gjykuar si të domosdoshme kërkesën për punonjësit e kualifikuar certifikuar, të lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim me kontratën objekt-shqyrtimi. Komisioni thekson, se trajnimi i punonjësve dhe pajisja e tyre më dëshminë për kualifikimin, është e detyrueshme për të gjithë punonjësit që do të përdorin pajisjet për shërbimin e dezinfektimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për pajisjen me certifikime të punonjësve, është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përpjesëtim me proceset e punës që parashikohen dhe volumin e kontratës që prokurohet, ndërsa për sa i përket profilit të certifikimit të kërkuar, autoriteti kontraktor këto përcaktime duhet t’i bëjë në përputhje me VKM 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”. Ndaj KPP thekson, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri në lidhje me përcaktimin e profilit të certifikimeve sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara. Referuar testit të proporcionalitetit, vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale (stafin), në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse, si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe legjislacionit të posaçëm.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]“Në radhë të parë kriteri është i paqartë dhe lë vend për interpretime të ndryshme, pasi është e paqartë nëse autoriteti kontraktor kërkon disponimin e më shumë se 10 (dhjetë) atomizatorëve?? Më shumë se 10 (dhjetë) pompave apo gjithsej 10 (dhjetë) pajisje, pra pompa dhe atomizatore pa specifikuar sa pompa dhe sa atomizatorë, por mjafton që gjithsej të jenë me shumë se 10 (dhjetë) pajisje?? Pse kërkohen më shumë se 10 (dhjetë) pajisje ndërkohë që numri i punonjësve është 10(dhjetë), ku përfshihet dhe drejtuesi teknik? Në procesverbalin e hartimit të dokumenteve nga AK-ja nuk ka asnjë argument teknik përse duhen këto pajisje dhe sa është numri minimal për secilin pajisje që kërkohet. Në vlerësimin tonë, duke marrë në konsideratë shërbimet, volumin e tyre janë të nevojshme minimalisht duhen 3(tre) atomizatore pasi me këtë pajisje një punonjës për 1(nje) ore bën mbi 10,000 m2 dhe për 35,000 m2 që kërkohen për këtë shërbim nuk nevojiten më shumë se 3(tre) atomizatorë. Në përfundim kërkojmë sqarimet dhe qartësimin e kriterit dhe kërkimin e jo më shumëse 3(tre) atomizatore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë pompa, atomizatorë për dezinfektim (më shumë se 10 copë) dhe të dorëzojë Faturat e Blerjes dhe Specifikimet Teknike të përkthyer dhe të noterizuara.

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.3.5. Në nenin 41, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Operatori ekonomik duhet të disponojë pompa, atomizatorë për dezinfektim (më shumë se 10 copë) dhe të dorëzojë Faturat e Blerjes dhe Specifikimet Teknike të përkthyer dhe të noterizuara.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Sa më sipër analizuar, gjykojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin, natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e

veçantë të vendosur. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi disponimin e 5 *pompave, dhe 5 atomizatorë për dezinfektim*, Komisioni i Prokurimit Publik pas analizimit të zërave të shërbimit, që do të kryhen në objektin e prokurimit, si dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si dhe aktit të trajtimit ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e 5 *pompave, dhe 5 atomizatorë për dezinfektim*, ndaj gjykon se kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e 5 pompave dhe 5 atomizatorë, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të ulë kërkesën për disponimin e tyre në propocion me sasinë e shërbimit që ka parashikuar në dokumentet standarde të tenderit.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik *“Egian Med” SHPK*, për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur, e thjeshtuar”* me Nr. REF-30235-05-20-2022, me objekt *“Dezinsektim i parqeve dhe objekteve në parqe”*, me fond limit 3,332,800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “*Egian Med*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri